



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 10.2.2023

Nr: 50

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE TË BASHKISË FIER, PËR
PERIUdhËN 24 JANAR – 2 SHKURT 2023**

Sot, më datë 10.2.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Bashkia Fier

OBJEKTI: Shqyrtim administrativ i raportimeve të veprimtarive të Bashkisë Fier për periudhën 24 janar deri më 2 shkurt 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, neni 21, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës së monitorimit 24 janar deri më 2 shkurt 2023, Bashkia Fier ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së, 7 (shtatë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

Data: 10.2.2023 Nr: 50
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin administrativ të raportimeve të veprimtarive të Bashkisë Fier, për periudhën 24 janar – 2 shkurt 2023”

1. Aktivitet “Takim me kërkesë të komunitetit Topojë”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
2. Aktivitet “Takim me kërkesë të komunitetit Dermenas”, raportuar në datë 25.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 28.1.2023,
3. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 27.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 1.1.2023,
4. Aktivitet “Inspektim/Kontroll”, raportuar në datë 27.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 1.1.2023,
5. Aktivitet “Tryezë diskutimi”, raportuar në datë 31.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 4.2.2023,
6. Aktivitet “Tryezë diskutimi”, raportuar në datë 31.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 4.2.2023,
7. Aktivitet “ Vizite ne disa sipërmarrje private në njësinë Levan, për t’u njohur nga afër me sfidat dhe arritjet e tyre”, raportuar në datë 31.1.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 4.2.2023.

Në datë 4.2.2023, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bashkisë Fier nëpërmjet email-it, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes ose t’i paraqesë ato në seancën publike të datës 8.2.2023, ora 11:00.

Pas njoftimit të kryer nga KQZ, Bashkia Fier nuk ka depozituar pretendime pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, krijoi bindjen se aktivitetet 1 dhe 2 janë raportuar jashtë afatit ligjor pa asnjë shkak të justifikuar. Nisur nga tematika e veprimtarive të raportuara, Komisioneri vlerëson se këto veprimtari përbëjnë veprimtari publike dhe Bashkia Fier ka shkelur detyrimin ligjor duke mosraportuar brenda afatit të përcaktuar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për 5 (pesë) aktivitetet e tjera të raportuara, vlerësoi se moskuptimi i drejtë i ligjit dhe llogaritja e gabuar e afatit 5 ditor është shkak që ka sjellë vonesën e raportimit të veprimtarisë publike. Në llogaritjen e afatit është përfshirë edhe dita e zhvillimit të aktivitetit e cila ka rezultuar në tejkalim afati.

Konstatohet se Bashkia Fier ka kryer një lapsus duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore dhe qëllimi i tyre nuk ka qenë mosraportimi i veprimtarisë publike apo shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit. Për këtë arsye, nisur edhe nga fakti se jemi në fillimin e zbatimit të kësaj procedure dhe kjo ka sjellë ngatërrimin/konfuzionin e institucioneve, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të kryhet pushimi i hetimit administrativ për ato shkelje që lidhen me këtë arsyetim deri në këtë periudhë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 21, pika 1 shkronja “dh”, dhe nenin 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

VENDOS:

1. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative, për z. Martin Dodi, Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Fier, me gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI